

Date Printed: 04/21/2009

JTS Box Number: IFES_65
Tab Number: 79
Document Title: Votimi ne Zgjedhjet Komunale
Document Date: 2000
Document Country: Kosovo
Document Language: Serbian/Bosnian
IFES ID: CE00923



* 1 6 9 3 6 2 F 6 - A D 0 8 - 4 B 7 A - 8 B 0 9 - 1 5 B 4 D 7 0 F 7 4 6 D *

Votimi në Zgjedhjet Komunale

Kur banorët e Kosovës të dalin në votime më 28 Tetor 2000 në zgjedhjet e para komunale të udhëhequra nga UNMIK-u, do të votojnë në bazë të sistemit proporcional të përfaqësimit me lista të hapura për të zgjedhur përfaqësuesit në Kuvendet shumëanëtarëshe Komunale në Kosovë.

Sistemi i përfaqësimit proporcional me lista të hapura siguron që si votuesit ashtu edhe entiteti për të cilin ata votojnë – partitë politike, koalicionet iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur- janë të trajtuar në mënyrë të drejtë. Përfaqësimi proporcional i përzgjedhjes, pikëpamjeve dhe interesave të votuesve realizohet me shndërrimin e drejtëpërdrejtë të votave të partive politike, koalicioneve ose iniciativave qytetare, në vende në Kuvendet Komunale. Nëse një parti politike, koalicion ose iniciativë qytetare fiton X% të votave atëherë ata do të fitojnë proporcion të njëjtë të vendeve, pra X% të vendeve, në Kuvendin Komunal.

Partitë politike, koalicionet, ose iniciativat qytetare kanë parashtruar listat e kandidatëve në radhitje që e kanë preferuar për komunat ku ata kandidohen në zgjedhje. Por kur votuesit të hedhin votën e tyre, si dhe të votojnë për partitë politike, koalicionet ose iniciativat qytetare, ata gjithashtu do të votojnë për kandidatët që ata i zgjedhin, duke ua ndryshuar me këtë rast radhitjen në listë. Vendet në Kuvendet Komunale do t'i fitojnë kandidatët që kanë fituar numër më të madh të votave, pa marrë parasysh

radhën në të cilën ata paraqiten në listat e dorëzuara nga partitë, koalicionet dhe iniciativat qytetare. Kjo zgjedhje i jep votuesit më tepër fuqi ngase i jep atij mundësinë që të kontrollojë se cilët kandidatë nga

listat e partive politike, koalicioneve, dhe iniciativave qytetare mund të zgjedhen. Kjo do të ishte duhur të nxisë partitë politike, koalicionet ose iniciativat qytetare që të prezantojnë lista të ndryshme dhe gjithëpërfshirëse të kandidatëve, dhe të nxisë vetë kandidatët që gjatë fushatës së tyre t'u qasen votuesve në mënyrë më të drejtëpërdrejtë dhe më personale. Kjo gjithashtu do të jetë në interes të përfaqësuesve të zgjedhur që, kur njëherë të jenë zgjedhur, të zhvillojnë këtë marrëdhënie të drejtëpërdrejtë me njësitë e

tyre zgjedhore nëpër komuna, duke përmirësuar me këtë rast perspektivën e përgjegjësisë dhe qeverisjes më të mirë në komuna. Kur të votojnë votuesit, ata duhet të shenjojnë emrin nga ata të partisë politike, koalicionit ose iniciativës qytetare që ata e zgjedhin

Perfaqësimi proporcional i përzgjedhjes, pikëpamjeve dhe interesave të votuesve realizohet me shndërrimin e drejtëpërdrejtë të votave të partive politike, koalicioneve ose iniciativave qytetare, në vende në Kuvendet Komunale.



**ZGJEDHJET
KOMUNALE 2000**

KOMUNA IME, VENDIMI IM

dhe votuesit gjithashtu mund të shkruajnë numrin e kandidatit të përzgjedhur nga ata në formularin e votimit. (Votuesit nuk mund të shenjojnë një parti, koalicion ose iniciativë qytetare dhe pastaj një kandidat nga partia tjetër, koalicioni ose iniciativa qytetare).

Nëse votuesit dëshirojnë të votojnë për një kandidat të pavarur, ata duhet vetëm të shenjojnë emrin e kandidatit të tyre të përzgjedhur në fletën e votimit.

Prandaj votuesit duhet të jenë të sigurtë se e dinë jo vetëm emrin e partisë por edhe numrin e kandidatit për të cilin dëshirojnë të votojnë para se të shkojnë në vendvotim.

Është përgjegjësi e votuesit që të zbulojë numrin e kandidatit dhe të plotësojë saktësisht fletëvotimin. Kjo do të sigurojë se vota e tyre është valide dhe se ajo numërohet për kandidatin që ata e zgjedhin.

KUSH KA DREJTË TË VOTOJË?

Secili që me sukses ka hyrë në regjistrin e votuesve, duke vërtetuar banimin e rëndomtë në Kosovë, do të ketë të drejtë juridike që të votojë në Zgjedhjet Komunale. Votuesit do të radhiten në një numër të ndryshëm të kategorive.

Votuesit e Rregullt

Shumica e banorëve do të regjistrohen që të votojnë në komunat ku ata banojnë. Votat e këtyre individëve njëherë do të numërohen në vendvotimin në të cilën është hedhur fletëvotimi, para se të dërgohen në Qendrën e Numërimit në Prishtinë ku do numërohen prapë dhe do t'i shtohen shumës së përgjithshme të komunës.

Votuesit në mungesë

Banorët që janë shpërngulur në komunat tjera kanë mundësinë që të votojnë për komunën e tyre të mëparshme në vendvotimet në mungesë. Votat e hedhura në vendvotimet në mungesë do të

numërohen në Qendrën e votimit në Prishtinë.

Votuesit Jashtë Kosovës

Përafërsisht 40,000 banorë të rëndomtë të Kosovës janë regjistruar që të votojnë nga jashtë vendit në Zgjedhjet Komunale. Votuesve jashtë Kosovës u janë dërguar paraprakisht fletëvotimet me anë të postës, për t'u mundësuar këtyre votuesve që të votojnë me plotësimin e fletëvotimeve të tyre dhe të mund t'i kthejnë ato

me anë të postës para ditës së Zgjedhjeve.

Fletëvotimet e kushtëzuara të votuesve

Fletëvotimet e kushtëzuara do të përdoren për të votuar ata votues zotësia juridike e të cilëve për të votuar nuk do të mund të përcaktohet

në atë kohë nga personeli i vendvotimit. Për shembull votuesi i cili shkon në qendrën e vendvotimit me dëftesë valide të regjistrimit por emri i të cilit nuk është në

Listën Përfundimtare të Votuesve, nga ai do të kërkohet që të shkojë në Vendvotimin në Mungesë ku atij do t'i dorëzohet fletëvotimi i kushtëzuar. Personeli i Vendvotimit në Mungesë do të shënojë në një zarf informatat që do të përcaktojnë zotësinë juridike për të votuar të atij votuesi, dhe do ta fusë fletëvotimin e plotësuar në këtë zarf, i cili pastaj do të mbyllet.

Të gjitha fletëvotimet në mungesë do të vërtetohen dhe, nëse janë valide, do të numërohen për komunat e tyre përkatëse në Qendrën e Numërimit në Prishtinë.

Rezultatet

Rezultatet përfundimtare për secilën komunë do të llogariten me grumbullimin e të gjitha fletëvotimeve të rregullta, në mungesë, jashtë Kosovës dhe të kushtëzuara në Qendrën e Numërimit në Prishtinë. Të gjitha rezultatet përfundimtare do të rishikohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve para se të vërtetohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Transparenca

Që të sigurohet që procesi i zgjedhjeve të jetë i qartë dhe i verifikueshëm në çdo fazë, KQZ-ja do të akreditojë vëzhgues nga bashkësia ndërkombëtare të koordinuar nga Këshilli i Evropës, Organizatat vendore, partitë, koalicionet ose iniciativat qytetare. Kjo do të minimalizojë mundësitë e numërimit të pasaktë ose të rrejshëm dhe e rrit besimin e publikut në integritetin e procesit të zgjedhjeve.

Votuesit duhet të jenë të sigurtë se e dinë jo vetëm emrin e partisë por edhe numrin e kandidatit për të cilin dëshirojnë të votojnë para se të shkojnë në vendvotim.

... procesi i zgjedhjeve të jetë i qartë dhe i verifikueshëm në çdo fazë...